



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 779, datë 26.12.2018

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.269, DATË 29.3.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN
E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET
E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË
TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR
TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE
PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE
E SHKOLLIMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 e 8, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 e 15, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shkronjat "f" dhe "g", të pikës 1, të vendimit nr.269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

- “f) Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë). Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës;
- g) Studentët e pranuar në vitin e parë akademik në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

~~KRYEMINISTRI~~

~~EDIRAMA~~

MINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

LINDITA NIKOLLA

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 6058/1
DATË 27-12·2018

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

